



VENDIM PËR HEQJEN E ANKESËS NGA LISTA

Data e miratimit: 15 qershor 2015

Numri i lëndës: 2014-40

Avni Hajdari

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 15 qershor 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. Ryan, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është parashtruar në emër të ankuesit nga i biri i tij, Adil Hajdari. Ankesa është regjistruar më 22 tetor 2014.
2. Më 27 maj 2015, Sekretariati i Panelit ka dërguar një letër tek z. Adil Hajdari, duke i kërkuar të ofroj autorizimin, i cili do ta autorizonte atë që ta përfaqësonte të atin e tij në procedurat pranë Panelit.

Sekretariati gjithashtu ka njoftuar atë se nëse nuk i përgjigjet letrës Paneli mund të konsiderojnë se ankuesi nuk ka ndërmend të vazhdoj me ankesën e tij dhe kështu ta heqë atë nga lista e lëndëve.

3. Letra për të birin e ankuesit ishte kthyer e padërguar. Sekretariati është përpjekur të kontaktonte z. Adil Hajdarin me telefon, gjithashtu pa sukses.

II. FAKTET

4. Më 13 shtator 2010, ankuesi dhe gjashtë të tjerë ishin akuzuar nga prokurori special i Kosovës për krim të organizuar dhe kontrabandë të emigrantëve.
5. Aktakuza ishte konfirmuar nga gjyqtari konfirmues i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës më 20 tetor 2010.
6. Më 17 qershor 2011, një trup gjykues i përzier i gjykatësve të EULEX-it dhe gjykatësve vendorë kanë marrë vendim mbi këtë lëndë. Ankuesi ishte shpallur fajtor për pjesëmarrje në një grup të krimit të organizuar në lidhje me kontrabandimin e emigrantëve dhe ishte dënuar me nëntëmbëdhjetë vjet burgim dhe me gjobë prej 50,000 euro. Ankuesi dhe të pandehurit e tjerë kanë apeluar kundër këtij aktgjykimi.
7. Më 3 tetor 2012, Gjykata Supreme në përbërje të një trupi gjykues të përzier të gjykatësve të EULEX-it dhe gjykatësve vendorë dhe të kryesuar nga një gjykatës i EULEX-it, ka hedhur poshtë të gjitha ankesat dhe ka vërtetuar dënimet e shqiptuara.
8. Më 2 prill 2014, Gjykata Supreme në përbërje të një trupi gjykues të përzier me gjykatës të EULEX-it dhe gjykatësve vendorë dhe të kryesuar nga një gjykatës i EULEX-it, ka hedhur poshtë kërkesën e ankuesit dhe bashkë të pandehurve të tjerë për mbrojtje të ligjshmërisë, si të pabazuar.

III. ANKESAT

9. Pa u thirrur në ndonjë instrument të veçantë ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ankuesi pohon se ishte dënuar në mënyrë të padrejtë dhe se është i pafajshëm për krimet për të cilat ai ishte dënuar.

IV. LIGJI

10. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me

rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

11. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
12. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.
13. Në pajtim me rregullën 25, paragrafi 5, i rregullores së punës, kur ankuesi përfaqësohet nga një person tjetër në procedurat në Panel, duhet që të paraqitet në Panel nga përfaqësuesi një autorizim me shkrim që vërteton cilësimin e tij/saj për të përfaqësuar ankuesin. Sipas rregullës 29 e tutje, paragrafi 1, i rregullores së punës, Paneli mund që në çdo fazë të procedimit të vendosë të heq nga lista e lëndëve ankesën atëherë kur rrethanat çojnë në përfundim se ankuesi nuk ka qëllim të vazhdoj me ankesën e tij/saj.
14. Përfaqësuesi i ankuesit nuk ka arritur të ofroj autorizimin dhe nuk ka qenë e mundur të kontaktohej në adresën dhe numrin e telefonit që ai i kishte shënuar në formularin e aplikacionit. Si rrjedhojë dhe pop ashtu edhe në mungesë të një treguesi të ndonjë shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut (shih rregullën 29 e tutje, paragrafi 2 i rregullores së punës), Paneli ka konstatuar se nuk do të jetë e arsyeshme të vazhdohet shqyrtimi i ankesës.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri, *vendos* që të heq këtë ankesë nga lista e lëndëve, në pajtim me rregullën 29 e *tutje* paragrafin 1(a) të rregullores së punës.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese